

Rrëfimi i Linda Ramës për lirinë, dashurinë dhe pushtetin

Linda Rama, bashkëshortja e Kryeministrit Edi Rama intervistë për emisionin “Aromë Gruaje” në RTSH,

INTERVISTA E PLOTË:

Ina Kollçaku: Mirëmbërë, të nderuar teleshikues. Sot, përveçse shumë e privilegjuar ndiej një përgjegjësi shumë të madhe për ju për të prezantuar këtë emision. Të them të drejtën, kjo është intervista më e rëndësishme e jetës sime dhe unë nuk kam turp të them të vërteta në ekran dhe kisha nevojë që ta ndaja me ju, për të kuptuar dhe mënyrën se si unë ndihem tani dhe gjithë përgjegjësinë, siç e thashë dhe më përpara, ndiej. Nuk kam një femër të zakonit, nuk kam një grua të zakonit sot dhe kjo jo për arsye pozicionimi, po për një karrierë që personalisht e kam kërkuar dhe e kam admiruar prej shumë vitesh nga larg. Në fakt që në ngjizje, në “Aromë gruaje”, emri i saj ka qenë një dëshirë dhe një fantazi që unë dhe regjisorja ime shpresonim, ëndërronim dhe donim të ndodhte dhe siç ndodhin gjërat e mëdha, kur ti do që të ndodhin, ti nuk di si të sillesh dhe nuk je gati për t’i përballuar ato. Unë do t’ju kërkoj ndjesë paraprakisht nëse bëj ndonjë lapsus apo nuk është performanca ime më e mirë dhe pse do doja që të shkëlqej dhe unë sot, po po i lë këto momentet egoiste personale, sepse ky emision është shumë herë më i rëndësishëm se mua dhe është i gjithë mesazhi frymëzues që “Aromë gruaje” synon që nga ngjizja e saj që të japë. Një nga vështirësitë më të mëdha që do të kem sot, është sepse përballë kam një grua që ka një etikë komunikimi që nuk është e kësaj bote, le ta themi, jam gojëhapur në shumicën e deklaratave, sidomos në mediat e huaja, të cilat i kam ndjekur me shumë kuriozitet, sepse është shumë e rrallë dhe çmuar që një grua shqiptare të japë këto lloj informacionesh për botën mbarë, me një përfaqësim dinjitoz për Shqipërinë. Ajo ka një karrierë personale, të frikshme më vjen ta them, sepse bëhet fjalë për një nga gratë më të rëndësishme në ekonomi. Dhe bëhet fjalë për një kërkuese mbi 50 kërkime në fushën e ekonomisë. Është një nga aktivistet e para dhe më të rëndësishme të shoqërisë civile dhe ka një kontribut të jashtëzakonshëm në edukim dhe në arsim si pedagoge. Ndihem që do ju lë dhe ju atë shije që ajo më ka lënë mua, sepse fjalët e saj në fakt janë si një testament. Përpara jush, zonja dhe zotërinj Linda Rama. Faleminderit shumë që erdhët në “Aromë gruaje”.

Linda Rama: Kënaqësi, Ina! Një parashtrim kaq të gjatë nuk e kisha as pritur dhe as dëgjuar më parë. Po kjo tregon që portat e shpirtit i ke të hapura, të mendjes gjithashtu dhe për mua, ky është momenti që vlerësoj, sepse bota është shumë e madhe. Dhe me portat e shpirtit hapur dhe mendjen e hapur, njeriu përfiton, përfiton shumë kështu që, po. Më pëlqeu kjo hapje.

Ina Kollcaku: Ndjej të nevojshme që të dyja bashkë të vendosim një etikë komunikimi. Është një nga gjërat që unë vlerësoj më shumë te ju. Dhe do doja të dija nëse do doni t'ju drejtohesha gjatë gjithë kohës me 'ju', ashtu si dhe e ndjej përgjegjësinë, apo do të preferonit që gjatë intervistës t'ju thërras Linda.

Linda Rama: Po, Linda. Nëse nuk do ishte opsioni Linda, do doja të më drejtoheshit me "ju". Meqënëse është Linda, gjithmonë unë dua Lindën.

Ina Kollcaku: Ndërkohë, mua paraprakisht mund të më shpëtojë dhe ndonjë "ju" gjatë intervistës.

Linda Rama: "Ju" mund të jetë. Pastaj e treta mënyrë është "ti". "Ti" nuk e preferoj. Ky, për shembull, është një mjedis ku "ju"-ja shkon. Ka mjedise ku "ju"-ja nuk qëndron. Kështu që mendoj që të dyjave ne dhe publikut i bën më mirë. Po Linda, Linda është e pakonkurrueshme në mënyrën e të drejtuarit.

Ina Kollcaku: Do të doja që të vlerësoja ndërkohë edhe një nga, patjetër, gratë më të rëndësishme që ne kemi në media, siç është Ilva Tare, që bëri një gjetje që jam xhelozë të them të drejtën, do doja ta kisha bërë unë. Ilva thotë në intervistën me ju, nuk ju drejtohet ju si zonja e parë, por drejtohet 'e para zonjë'. Dhe më lind një pyetje, zonjë, lind apo bëhesh sipas jush?

Linda Rama: Nuk e ka thënë Ilva. Ilva e ka përdorur, mendoj unë, sepse bukuria e kësaj shprehjeje, përtej meje është fakti që për herë të parë këtë e ka artikuluar një burrë për mua. Dhe sigurisht, Ilva ka patur dëshirën që ta citojë dhe e ka risjellë. Tani ju po e risillni përsëri. Dhe kjo e bën edhe më të rëndësishëm faktin që një burrë një ditë e tha këtë dhe mbase gjatë intervistës edhe mund të mund ta shtjellojmë. Edhe nëse ju nuk do dilni me një pyetje, mund të dal unë tek kjo, sepse është një moment që përbën një lloj interesi të caktuar publik. Ndërkohë, më lejo para se t'i jap përgjigje pyetjes, të ndaj një emocion shumë të fortë që pata para se të vija këtu, që mbase ma lehtëson pozitën e intervistës me ju në kuptimin emocional. Unë futem në godinën e Televizionit Publik Shqiptar, Radio Televizioni Publik Shqiptar, pas 3 dekadave. Mund të jetë fiks 3 dekada me një diferencë muajsh. Kam qenë këtu në vitin 1995 për të shpjeguar skemën e privatizimit masiv, e cila drejtohej nga unë, në një komunikim me gazetarin që mbulonte çështjet e ekonomisë. Komunikimi ishte live, sepse kishte edhe ndërhyrje nga publiku, të themi, populli i interesuar për procesin e privatizimit, sepse ishte masiv si proces. Unë vajta vizitova edhe studion. E mbaja mend shumë mirë. Mbaja mend korridorin, mbaja mend hollin e vogël. Mbaja mend dhe studion që ishte një studio e madhe. Dhe regjisorja Vasilika më shoqëroi deri aty dhe kjo godinë është një godinë sipas meje, e mbushur me emocione. Ato e dominojnë. Ndërkohë që mendoj që prezenca e Radio-Televizionit, në jetën time është shumë e hershme. Është mbase që

përpara se unë të filloja shkollën, mbase 5 vjeç, 6 vjeç, për shkak të xhaxhait tim, Hasan Basha, që ishte në ekipet e para të televizionit, radio televizionit, teknik zëri, së bashku me grupin e tjetër të çunave, siç i njihnim ne në shtëpinë time; Petraqi, Shefki Petrela, të gjithë tironca. Gëzim Kallfa, Lul Balla kameramani, Besnik Shima, një pjesë e të cilëve në fakt kanë lënë kujtimet mes nesh. M'u zgjuan të gjitha ato figura që ishin në oborrin tonë, që komunikonim. Televizioni ishte aty tek ne, me të gjithë ngjarjet që ndodhnin, dhe ne kishim edhe shtëpinë shumë afër televizionit. Shtëpia e prindërve të mi, e gjyshërve të mi, është tek Liceu Artistik. Kështu që televizioni është pjesë e jetës time dhe unë isha shumë e emocionuar kur shkela këtu pas kaq shumë viteve, edhe kur preka atë momentin tim të parë. Zonjë lind apo bëhesh? Së pari të definojmë ç'do të thotë "zonjë" dhe mendoj që biem dakord që bëhet fjalë për një grua apo burrë, zonjë apo zotëri, që karakterizohet nga një shkallë e lartë dinjiteti dhe integriteti, nga një edukatë po dhe nga sjellje dhe prezencë e hijshme dhe fisnike, që përsëri është një karakteristikë që mund ta dallojë disi nga jeta e shpenguar që mund të jetë përreth. Dhe mendoj që njeriu duhet të ketë një premisë fillestare për të kërkuar në këtë drejtim. Po vetëm si premisë fillestare. Më pas mendoj që është proces kultivimi, është proces formimi. Bëhesh domethënë, për t'i dhënë përgjigje. Mendoj që fillon hershëm. Fillon qysh atëherë kur përpiqesh që të kuptosh çfarë të pëlqen e çfarë s'të pëlqen; çfarë është e tolerueshme, çfarë s'është; si duhet të komunikosh; çfarë të tërheq; çfarë të bën që të mos e afrohesh tek vetja? Dhe këto në fillim vijnë si shije nga mjedisi, pastaj gradualisht këto të kthehen në prezencë, prezencë konkrete, të formësuara tek individë të caktuar, burra dhe gra. Sepse cilësi të veçanta i gjen në njerëz të ndryshëm. Çdo njeri ka cilësitë e veta, çdo njeri ka segmentin e "zonjës" dhe të "zotërisë". Tek secili individ i gjen këto. Përpjekja është për t'i bërë bashkë, dhe kur ti i shikon këto prezencat, atëherë mund të lindë dëshira dhe nxitja për të qenë dhe ti një si ato dhe fillon edhe e kultivon këtë, e kultivon, e kultivon. Dhe është një proces i gjatë ky. I cili besoj, pas një momenti të caktuar, kur ti ke arritur të definohesh, përpjekja më e madhe është ta mbash. Se jeta ka të papritura shumë të mëdha dhe mundet që të të ushtrojë presione të caktuara, që është fare normale që në një moment edhe mund të mos t'i përballosh dot. Dhe nuk je e gjykueshme. Sepse është një kërkesë personale. Por gjithsesi do përpjekje që ta mbash këtë investim tëndin të bërë në vite. Dhe mendoj që (unë e kam parë këtë tek njerëz të caktuar) është si një proces që përfundon atë moment kur shpirti shpëputet nga trupi. Dhe pastaj gjithë ajo që ke jetuar këtu, është pronë e kujtimit këtu, por është pronë edhe e shpirtit tënd në një univers tjetër.

Ina Kollcaku: Kam një gjë shumë të rëndësishme që ndjej ta them, kur ju zyrtarisht ishit grua e kryeministrit, për herë të parë, unë si një vajzë shqiptare ndjeva një lloj krenarie, sepse rëndom ne nuk kishim parë gruan e dikujt që të vlerësohej jashtëzakonisht e ndarë nga fakti që u bë grua e dikujt dhe unë personalisht, me gjithë kauzat feministe që i kam ndjerë gjithë kohës, të rrënjosura brenda meje, ndjeva një krenari të jashtëzakonshme që kjo grua nuk po bëhej më, qoftë edhe mediatikisht, thjeshtë grua e dikujt, si ne kemi parë, po ishte një grua me vlera të çmuara individuale, vetë me atë që përfaqëson. Jam kurioze, ju besoni në destin, në fat, që gjërat janë shkruar, që të frymëzosh, të inspirohesh, pastaj të pozicionohesh, etj., etj, apo besoni në gjëra që ne i bëjmë vetë të ndodhin?

Linda Rama: Ajo që mund të them lidhur me atë moment është që ka qenë një mister në rastin më të mirë se kush është gruaja që po martohet me Edi Ramën. Ka qenë një mister i madh, ka qenë një bisedë e madhe që ndodhte në javën tonë të martesës dhe unë nuk isha një njeri që më njihte publiku. Mua më njihnin komunitetet lokale, më njihnin kolegët e mi, më njihnin studentët. Më njihnin, po përsëri ishin numra të vegjël. Për shkak të Edit, unë u prezantova me publikun dhe aleati më i madh që kam patur në atë moment kanë qenë ato, që thatë më parë, studimet e mia. Kanë qenë arsimimi im, diplomat e mia. Kanë qenë pikërisht ata kolegët, komunitetet lokale, një sy dhe një mendje që mua më njihte, më shihte, më kishte parë më parë dhe unë e dija që ata në atë moment ishin me mua.

Ina Kollcaku: Sepse edhe të donin.

Linda Rama: Pikërisht. Dhe ato ishin me mua. Këta ishin aleatët e mi publik. Studentët e mi, kudo që ata ishin, kështu që kjo lloj aleance në atë moment ishte siguroese. Përtej kësaj, pastaj ka qenë një histori e gjatë, historia e prezantimit të një njeriu publik të ekspozuar publikisht me publikun vetë. Ai do kohën e vet, do qetësinë e vet, do durimin e vet, edhe nga publiku në raport me figurën publike, por edhe nga vetë ti, në raport me publikun. Është një raport shumë interesant, por mbase në një bisedë tjetër mund ta zhvilloj. Ndërkohë, a janë destin gjërat? Unë jam një njeri që besoj në një energji që është një energji e përtejme. Jam rritur me këtë lloj fryme nga gjyshërit e mi, nga prindërit e mi. Këtë e kemi patur një kod të dakordësuar brenda familjes, kodin fetar dhe sigurisht unë e besoj këtë, e kam bërë timen këtë. Edhe me kuptimin që kërkoj t'i gjej apo t'i jap botës. Ndërkohë që mendoj që ne të gjithë, jemi këtu, kemi ardhur në këtë botë, për shkak të një vullneti hyjnor dhe është një vullnet hyjnor që na ka sjellë këtu për të bërë një rol, çfarëdolloj që roli të jetë ky. Rolin ne e formësojmë vetë, sepse kjo bota ku jemi, është një botë kaq e larmishme, është një botë e larmishme në kuptimin e natyrës, në kuptimin e njerëzve, në kuptimin e marrëdhënieve, saqë po kaq e larmishme dhe e pafundme është mënyra që ti zgjedh. Gjithmonë e kam parë si një moment të adhurueshëm faktin, që si ka mundësi që natyra është kaq perfekte? Natyra është perfekte. E keni vënë re sa perfekte është natyra, sa perfekte janë kafshët dhe insektet në mënyrën se si e ndërtojnë ekzistencën e tyre? E keni parë sa të bukur janë? Për shembull, sa i bukur është gjeli? E keni parë? Unë tani jam dhe në fshat dhe kam edhe gjela dhe pula në shtëpi; E keni parë, për shembull, se sa i bukur është gjeli? sa i bukur është palloi? Kur i shikon ato, ti thua, po si është e mundur? Po edhe një insekt që nuk të pëlqen, ose një kafshë që nuk të pëlqen prapë ka atë misterin e vet, ndërkohë kur futen në raporte me njëritjetrin edhe njerëzit, edhe kafshët, edhe natyra, aty pastaj egërsohen. Aty ndodh një gjë tjetër, që është përsëri shumë interesante. Mendo që ky perfeksioni të ishte dhe në raporte. Do të ishte një tmerr. Dhe mua më duket që kjo është bukuria që ne jetojmë. Është një bukurie e jashtëzakonshme dhe kjo na bën edhe të dallueshëm, kjo na bën edhe të vlefshëm, kjo na jep mundësinë që ne nga gabimet të përfitojmë, të mësojmë. Eksperiencat janë po aq të larmishme gjithashtu. Kështu që vullneti hyjnor është i kombinuar me këtë, me rolin që ne gjejmë vetë. Janë

ca shenja që të vijnë herë pas here. Telepatia, për shembull, një prezencë në ëndërr ose të tjera momente, ngjarje që ndodhin dhe duket sikur i ka thurur një fuqi e përtejme, se të çudisin, të befasojnë.

Ina Kollcaku: Ndoshta tani është dhe intuita ndonjëherë.

Linda Rama: Po si erdhi ajo intuita? Dhe më pas të duhet ty të orientohesh në to, por ato mund të të definojnë në një moment dhe jetën, sigurisht, në funksion të asaj se çfarë ke bërë ti me to. Dhe pastaj është ajo mrekullia e madhe fare që të bën të jesh shumë realist në këtë lloj bisede, që nuk kemi një vizitor të kthyer nga bota e përtejme, nuk kemi një shpirt të kthyer. Kemi shpirtrat e vjetër, që edhe këtë e besojmë. Zaho ishte shumë i vogël, mund të ishte 3- javësh kur reagonte ndaj komunikimeve tona në një mënyrë si i rritur dhe ne thonim, çfarë është? Ka qënë këtu? Në qoftë se unë bëja sikur mërzhitesha, mërzhitej dhe ai. Me mënyrën e vet shprehte mërzhinë e tij. Unë rrudhesha, rrudhej edhe ai; Edi rrudhej, rrudhej edhe ai. Atëherë, ku ishte kjo? Si ndodh kjo në muajin e parë? Si mund të ndodhë kjo? Dhe ti fillon edhe mendon, mos ka jetuar njëherë? Dhe janë këto kuriozitetet. Dhe për shkak se s’kemi të tjerë vizitorë të kthyer këtu, kemi dhe kuriozitetin, duam ta besojmë dhe kemi dhe nevojën e surprizës, të jemi të surprizuar edhe kur ikim.

Ina Kollcaku: Na bën mirë ndërkohë.

Linda Rama: Po le të ikim me një surprizë të madhe dhe t’shohim pastaj se çfarë është. Kështu thotë një mikesha ime: “Nuk të garantoj- thotë, se çfarë do jetë andej, po do jesh shumë e surprizuar”. Është një mikesha ime që i ka kaluar të 80-at tani, e huaj nga vendet nordike dhe njëherë ma ka thënë këtë.

Ina Kollcaku: Jam tmerrësisht kurioze të di, nuk dua të di dhe do të pyes një, çfarë peshe ka të jesh gruaja e kryeministrit, sepse dua të di çfarë peshe ka të jesh burri Linda Ramës, me gjithë ngjyrat që ju ofroni, me gjithë dinamikat, me gjithë luftën, me gjithë karrierën, me gjithë arritjet. Sa e rëndë është kjo?

Linda Rama: Ka një dimension në jetën e një çifti apo të dy njerëzve që kanë vendosur të jetojnë bashkë, i cili është një dimension njerëzor. Kush është ky sipas meje? Është ai që në fakt shoqëron vendimmarrjen e çdo njeriu që në një moment të caktuar thotë “unë nuk do jetoj vetëm, unë do bëhem dy me personin tjetër”. Flasim këtu jo për kohën kur ishin martesat e ndërmjetësuar, por për një martesë, e cila është vullneti i një dashurie midis dy njerëzve. Në momentin kur ti vendos të marrësh këtë hap prevalon dashuria, apo jo? Dhe sigurisht, edhe disa

vlerësime që ti arrin të kesh ndaj njeriut me të cilin vendos, ose ai për ty. Por gjithsesi janë vlerësime pothuajse në distancë, ndonjëherë intuitive, ndonjëherë edhe të bazuara, po të paprovuara në planin personal. Ti asnjëherë nuk e di nën të njëjtën çati si do të zhvillohet e gjithë ngjarja, domethënë, mungesa e njohjes është në një shkallë të lartë për atë që vjen. Megjithatë, merret një vendim. Pse merret ai vendim? Sepse ti në atë moment e di, që jeta pa të nuk është aq e bukur sa me të. Është kaq e thjeshtë. Për shkak të një dashurie. Dashuria s'mund të arsyetohet në atë moment, nuk mund të jetë e kritikueshme. Dhe çfarë bën, mendoj unë? Në momentin e parë ky është një bast i madh. Ti vendos një bast të madh, mbase është basti më i madh i jetës tënde. Kush është basti? Basti është që ti në atë moment beson tek gjëra të cilat s'kanë ndodhur. Ti thua që "do ndodhë kështu dhe unë e besoj këtë". Pra e jep besimin në avancë. Dhe më pas, çfarë të duhet të bësh? Çfarë duhet të bëjnë të dy? Kush është pesha e të dyve? Pesha e të dyve është të provojnë që janë në nivelin e bastit. Dhe janë nivelin e asaj dashurie, atij besimi reciprok, të asaj dashurie të madhe që ka qenë nxitësja për të marrë vendimin për të qëndruar së bashku. Ndonjëherë, pesha e bastit është më e madhe se pesha individuale e të dyve. Nuk duket bukur apo jo? Kështu basti fillon dhe zbehet. Ka raste kur pesha shtohet. Madje është më e madhe sesa ajo që ti ke menduar në fillim, ditën kur e more këtë vendim, pra se basti i vënë. Dhe kjo jo vetëm e bën bastin të bukur, të sigurtë, po qëndron më bukur. Të dy peshat qëndrojnë bukur.

Ina Kollcaku: Je si të jesh gjatë gjithë kohës emocionuar....

Linda Rama: Është shumë më shumë, sepse jeta t'i ofron të gjitha. Ama, ti i mban. Dhe kjo është pesha, është ajo që mban. Nuk është pesha sa rëndon, është pesha që mban. Janë bashkë, janë rezultante. Atëherë është më e madhe. Dhe jeta t'i jep të gjitha. Të jep emocionin, të jep rrëzimin, të jep ankthin, të jep frikën, të jep ngadhënjimin, të jep shkëlqimin, t'i jep të gjitha.

Ina Kollcaku: Ndonjëherë 'pesha që mban gruaja e pilotit thonë që është dhe më i rëndë se e pilotit'. A ekziston edhe kjo ndërkohë mes rreshtave të asaj që po thoni ju?

Linda Rama: Kjo e pilotit, është një peshë e një lloji tjetër. Mos t'i vëmë në kandar, se nuk mund të jenë në të njëjtin kandar. Kush është kandari i përbashkët? Është që piloti t'ia dalë, të kapë tokën. Të fluturojë lart kur është për të fluturuar lart, po të arrijë në destinacion. Dhe ky është një ankth shumë i madh në rastin e jetës së tij dhe këto ankthe e shoqërojnë edhe mbështetësen ose njeriun që zhvillon jetën së bashku me njeriun kryesor. Ndryshimi është që piloti e ka në dorë vetë që të shkojë lart dhe të kapë tokën, ndërsa ai që e pret nga larg nuk ka asgjë në dorë. Ai vetëm duhet të lutet që piloti t'ia dalë.

Ina Kollcaku: Ka vetëm dashuri.

Linda Rama: Ka dashurinë, ka mbështetjen që piloti të jetë i qetë kur të vijë në shtëpi. Ka të gjithë pjesën tjetër, por nuk e ka timonin e pilotit në dorë apo pajisjen e madhe që kanë pilotët përpara. Në rastin e peshës të Edit për mua apo times për Edin ka një dimension tjetër pastaj, që dallon nga dimensionin i njerëzve, të cilët zhvillojnë jetën e tyre të zakonshme.

Ina Kollcaku: Me më pak përgjegjësi, le të themi...

Linda Rama: Në rastin tim dhe të Edit, pesha jonë nuk matet më se çfarë bën Edi për mua dhe unë për Edin. Pesha jonë matet me një peshë tjetër, me një dimension tjetër dhe është pesha e besimit të njerëzve, të cilën ti duhet ta mbash. Si? Duke qënë çdo ditë koshient për peshën e vendimeve të tua tek kombi dhe tek vendi. Kjo është një peshë që e definon raportin tonë në kuptimin e një dimensionin të shtuar.

Ina Kollcaku: Thashë që janë fjalë që tingëllojnë si testament kështu që mund të më shohësh ndonjëherë dhe që jam përhumbur duke dëgjuar fjalët tuaja. Por ju keni një përgjigje brilante televizive të një shprehje që personalisht nuk më pëlqen fare, që është “burrë i fuqishëm, grua e fortë”. Gjithmonë kam pas një lloj irritimi me këtë, me këtë shprehje, ama ju publikisht jeni përgjigjur ashtu si thashë, në një mënyrë brilante, duke thënë që një burrë i fuqishëm ka nga mbrapa një nënë të fortë. Ndërkohë, ne gazetarët kemi qejf që të marrim pak edhe vesh lart e poshtë çfarë ndodh. Si mund të jetë Linda në jetën e saj të përditshme? Si mund të jetë e të tjerë, e të tjerë? Dhe gojëdhënat dhe fjalët kanë qenë gjithmonë që ju, përveçse keni qenë shumë e dedikuar ndaj vjehrrës tuaj ose teta Netës, siç njihet në lagjen e saj, keni qenë pranë saj çdo ditë deri ditën e saj të fundit, që tregon shumë për një grua, sidomos për një grua kaq shumë të suksesshme, që tradicionalen dhe avangardën e shkrijnë kaq bukur sa ju. Ju mungonte teta Neta? A bëhet ndonjëherë më e lehtë me kohën një marrëdhënie si ajo që ju e ndërtuat me të, me shumë dashuri, si të ishte një nënë për ju?

Linda Rama: Më rikthyet tek ajo intervistë, për ta thënë më gjatë. Unë aty kam thënë që “një njeri i madh është produkt i një babai të madh dhe e një nënë të madhe”. Dhe unë e besoj këtë. Të madh në dimensione. Të cilat ne i gjejmë edhe në jetën e përditshme, pra pasqyrimin e dimensioneve të prindit tek fëmija. Unë e kam prekur vdekjen kur kam qenë adoleshente, për herë të parë. Kam humbur xhaxhain tim në moshë shumë të re. Xhaxhai im ishte, 29 vjeç, kur aksidentalisht u largua nga ne. Dhe unë e mbaj mend dhe është hera e parë që flas për këtë. S’kam folur kurrë as në shtëpi për këtë moment. Por është një moment që më konfirmohet. Unë e mbaj mend kur kjo ndodhi dhe ka qenë një segment kohe i caktuar me atë rast ku për mua, edhe adoleshente, bota e humbi kuptimin, nuk kishte më kuptim. Ishte një moment ku unë thashë, jeta s’ka më kuptim. Dhe po ai moment kur mu duk sikur bota ndaloj. Literalisht, mua mu duk sikur

ndaloj. Dhe kam kuptuar me kalimin e kohës që ai kuptim, ai segment kuptimi, nuk vjen më. Ti nuk je më kuptimplotë në mënyrën se si e zhvillon jetën. Ti e ke të cunguar. Unë kam humbur gjyshërit e Reas. Ata kanë qenë një prezencë e jashtëzakonshme në jetën time gjithashtu. Unë kam humbur kolegun me të cilin themelova zyrën para disa viteve. Ka humbur një pjesë e kuptimit për mua me largimin e tij dhe duhet ta gjej mënyrën si ta plotësoj këtë humbje, por nuk është e njëjta gjë. Kam humbur gjyshërit e mi, të gjithë gjyshërit e mi. Nuk e ka bota më të njëjtin kuptim sesa kur i ke të gjithë ata që janë prezenca të rëndësishme në jetën tënde. Me mamanë e Edit, unë bisedoja shumë gjatë. Kuptoheshim mirë, ishim në procesin e njohjes së njëra-tjetrës. E kemi marrë kohën për ta njohur njëra-tjetrën. Dhe për këtë shkak dhe arrinim të kishim një raport intensiv dhe kur themi intensiv, nuk është thjeshtë kohë, po kohë e jetuar, kohë e jetuar me bisedë, me mendim, me emocione, me kujdes. Kur ne ishim të dyja me mamanë e Edit, ishte shumë e habitshme, gjithkush tjetër bëhej i tepërt dhe ajo e kishte të rëndësishme këtë. Në momentin që ne ishim të dyja, megjithëse mund t'i donte që të gjithë njerëzit që mund të ndodhnin aty, ishte shumë e natyrshme që gjithkush të ishte i tepërt. Sepse aty ishim ne, të dyja. Dhe biseda dhe koha dhe momenti ishte për ne të dyja. Në fillim është dhimbja. Kur e humbet këtë, është një dhimbje e madhe. Unë nuk do ta bëja këtë rrëfim dhe nuk e kam bërë këtë rrëfim kur ishte viti i parë kur kjo ndodhi. Tani jam pak më e qartë, në kuptimin se si përballohet. Është një dhimbje e madhe dhe ke nevojë të luftosh me dhimbjen që shkakton largimi. Duhet të përcaktoje një rutinë të re. Sepse ti kishe humbur një pjesë të rëndësishme të rutinës tënde. Duhet të mbaje në ekuilibër njerëzit e tjerë, Edin. Ishte një humbje shumë e madhe për Edin dhe të gjithë të tjerët në familje. Pastaj, fillon dhe ballafaqohesh me mungesën. Është dhimbja në fillim. Nuk të lë dhimbja të ndjesh mungesën. Dhimbja dhe nevoja për të rivendosur një rutinë të re. Pastaj të vjen mungesa. Ty të mungon. Atëherë çfarë do të bësh? Do të fillosh, do të merresh, do të gjesh mënyrën tënde si ta sjellësh. Duhet të lexosh shenjat se si vjen ajo tek ti. Këtë do ta gjesh vetë. Është puna jote. Po ama është një punë e përditshme që duhet ta bësh, ose sa herë që ti e ndjen këtë pjesë të nevojës tënde. Për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, a të mungon mamaja e Edit? Mua më mungon jashtëzakonisht shumë. Në një mënyrë të pazëvendësueshme më mungon mamaja e Edit. Por unë e kam gjetur dhe gjej tërë kohën mënyrën, për ta sjellë në çdo lloj forme mamanë e Edit në të përditshmen time. Kjo është ajo që unë në fakt, e kam bërë për mamanë e Edit, e bëj për gjyshërit e Reas, e bëj për gjyshërit e mi. Unë e gjej mënyrën, e kërkoj. E mendoj se si t'i risjell. Me një shije, me një ushqim, me një bisedë, me një send, me një kujtim, me një rrëfim. E gjej. Po ata janë tërë kohën pjesë e të jetuarit.

Ina Kollcaku: Unë falenderoj shumë që e ndatë këtë pyetje me mua dhe dua t'ju kërkoj ndjesë nëse ishte pa vend ose e ngacmova një gjë.

Linda Rama: Është ok. Unë e kam kaluar atë pengesë, dhe ja, kjo është një mënyrë për ta ri sjellë. Dhe me atë rast, unë risolla dhe mungesa të tjera që kam pësuar në jetë.

Ina Kollcaku: Duhet të kaloj pak në publicitet, por dua që gjatë publicitetit të mendoni filozofinë e bukur që solli dhuroj Linda për ju mbi jetën dhe vdekjen dhe mungesën e njerëzve që ne i duam shumë. Jemi rikthyer sërish në studio dhe unë dua të eksploroj disa role të tjera sociale që në fakt Linda Rama ka. Dhe përpara se të kaloj tek Linda si nënë, si gjyshe dhe dimensione të tjera, dua ta rikthej në vajzën e vogël. Gjithmonë jam kurioze për fëmijën e brendshëm, ndoshta edhe nga formimi dhe shkollimi im, dhe ne psikologët të vdesim për inner child –in dhe fëmijën e brendshëm. Dhe më ndodh shpesh në ditë të vështira, sidomos në ditë kur jeta nuk është aq e mirë me mua, kam nevojë për mami time dhe dua të iki te mami im dhe ta përqafoj. Ju çfarë ju kthen te nëna juaj për ta përqaftuar atë nevojën që nuk di ndoshta si ta shpjegoj me fjalë ekzaktësisht momentin e nevojës për të ndjerë përqaftimin e mamasë tënde.

Linda Rama: Unë dua të jem me mamin tim kur lëndohem padrejtësisht. Është e vetmja strehë ku dua të shkoj. Te mami dhe te babi. Shkoj atje sepse edhe heshtja nuk ka nevojë të shpjegohet. Edhe në qoftë se unë nuk flas asnjë fjalë, mami dhe babi mua më kuptojnë shumë mirë, më njohin plotësisht, nuk më gjykojnë. Ata e dinë energjinë time kur ajo është në nota të ulëta, ata e ndiejnë dhe jam e bindur që nuk më dyshojnë, i kam aleatë të pakushtëzuar. Shkoj atje tek prezenca sigurorese e mami. Mami im është një grua me një inteligjencë dhe me një energji shumë të posaçme. Unë strukem te babi dhe kam proteksionin e mami. Kështu ka qenë gjithmonë. Strukja ime ka qenë te babi. Unë babin kam patur mbështetësin tim shumë të madh. Mami ka qenë kërkuesja e madhe për mua. E luanin shumë bukur këtë dyshe, këtë tango në raport me mua. Dhe është si rikthim në gjendje ekuilibri. Kur dal që andej, unë jam në një ekuilibër tjetër, me të cilin mund të vazhdoj qetësisht. Po, ai është momenti, lëndimi i padrejtë që më çon menjëherë atje. Edhe kur lëndimi ndonjëherë ndodh edhe nga fëmija yt, pa dashje. Ndodh që të kalojë kufiri e ti lëndohesh, se nuk të përgjigjet, nuk të kupton, nuk do të të kuptojë në atë moment. Dhe më ka ndodhur në një moment, i kam thënë Zahos, për shembull. Stop! U bë shumë që unë të them një gjë, dhe ti insiston. Dua të jem tek mami im në këtë moment. Unë jam mamaja e tij, që në atë moment dua të shkoj te mami im dhe kjo më duket plotësisht legjitime. Dhe çudi, kjo ka kaq shumë fuqi. Aty dhe ai ndalon. Nuk e kërkon më, se dhe ai e di që mami për të është një gjë shumë e rëndësishme. Aty vjen edhe koshienca e tij në një ekuilibër të drejtë dhe kjo është fuqi shumë e madhe. Fuqia e nënës është një fuqi e jashtëzakonshme, mendoj unë.

Ina Kollcaku: Ndërkohë, paralelisht te vetja juaj, shihni të pasqyruar një sjellje tipike të nënës tuaj, që ju e bëni me fëmijët dhe do donit që edhe Rea ta bënte me fëmijët e saj dhe Zaho, pra si të themi një sjellje që dhe ju bën ju krenar dhe atribuoni arritjet.

Linda Rama: Aftësia për t'ia dalë me dinjitet dhe duke e bërë veten më të mirë. Mamaja ime ia ka dalë të jetë një grua që ia del, ia del me dinjitet. E gjen mënyrën. Ia del duke u bërë një vetë më e mirë. Prindërit e mi të dy janë të tillë. Ata ia kanë dalë. Ata ia kanë dalë me dinjitet dhe me një vete më të mirë dhe mendoj që këtë medalje ata nuk kanë nevojë që të vijojnë të përpiqen për ta marrë. Ata këtë e kanë marrë. Dhe të shohësh që një medalje të tillë të ta japin fëmijët e tu

nëpërmjet gjithë adhurimit që kanë, kujdesit që kanë në të gjallë mendoj, që është një arritje shumë e madhe. Ka njerëz që luftojnë tërë kohën për ta patur. Prindërit e mi e kanë marrë. Dhe unë jam shumë e lumtur për këtë, që ato këtë e kanë parë këtë në të gjallë.

Ina Kollcaku: Më vjen shumë mirë, ndërkohë jeta juaj tani është e përzier me politikën. Duam apo nuk duam ne dhe nuk i shpëtojmë dot kësaj. Ka disa pyetje që unë do t'i jap dy-tre shije dhe do pres rrëfimin tuaj, ashtu si vetëm ju mund ta shpjegoni në nivel filozofik. Çfarë ndryshimi ka politika në filozofi dhe në praktikë? Si mund të jetojë shoqëria civile me pushtetin dhe me kryeministrin? Dhe si ndikon politika në dinjitet dhe liri? Dhe a ndikon?

Linda Rama: Pjesa e filozofisë politike dhe e politikës, si instrumenti i ndryshimit të përditshëm të realiteteve me vendimmarrjet e saj. Filozofia jep ligjshmëritë. Pra cilat janë ligjësitë që kanë dalë nga barku i mijëvjeçarëve, nga barku i kohës, nga të gjitha eksperiencat dhe të gjitha rrahjet e mendimeve dhe të praktikave qeverisëse, drejtuese, politike, e kështu me radhë. Kurse politika është arti i të përditshmes, ndryshimi i realitetit në mënyrë të përditshme. Jo vetëm me fuqinë e mendimit, po me fuqinë e veprimit. Është një dinamikë plotësisht tjetër, dinamika e politikës si praktikë me dinamikën e filozofisë, në të cilën duhet të mbështetet qasja politike. Po aq i larmishëm sa ç'është realiteti, aq të larmishme janë vendimmarrjet dhe mënyrat që politika gjen për t'iu përgjigjur nevojave. Filozofia nuk e ka këtë dinamikë. Ajo ka kohë, filozofia ka kohën e vet.

Ina Kollcaku: Duket shumë e thjeshtë të japësh mendje se si mund të bëhet diçka.

Linda Rama: Ka dhe ajo sfidat e veta, kur do, kur kërkon ti përdori. Sepse duhet ta vendosi në pamundësi politikën, në rastet kur filozofia mendon që politika ka shmangie të rëndësishme nga pikërisht ato ligjësitë që koha i ka provuar. Dhe ky është roli i filozofëve. Është një rol shumë i shumë i rëndësishëm. Ti ke dëshirë të ulesh me një filozof, e di sa bukur është të flasësh me një filozof? Është një kohë e shpenzuar shumë cilësisht. Dhe unë i shoh me shumë vlerësim filozofët, sepse ata janë ndriçues, janë shumë ndriçues përgjithësisht. Edhe kanë një lloj diskomforti me veten e tyre. Më duket si puna ime një filozof. Unë jam me një politikan vendimmarrës, po unë nuk marr dot vendime në vend të tij. Po mendoj që ca gjëra mund t'i bëja ndryshe, po s'kam gjë në dorë. Kështu janë dhe filozofët. Janë në këtë diskomfort. Mendojnë që mund t'i bëjnë më mirë, por nuk i kanë në dorë për t'i bërë më mirë edhe kjo është e bukur, është e bukur si gjendje e tyre.

Por nga ana tjetër, unë kam parë për shembull në vetë të parë, filozofë, të cilët janë futur në politikë dhe kanë marrë formën e enës politike. Nuk kanë arritur dot të identifikohen me ligjësitë.

Ato mund të bëjnë lehtë filozofin në tavolinë, por aty brenda unë nuk e di si qëndrojnë në petkun e filozofit, ndërkohë që janë të detyruar.

Ina Kollcaku: Duhet të bësh gjëra të ndodhin në fund të fundit...

Linda Rama: Jo, po edhe duhet të pranojnë deformimin. Pranojnë një padrejtësi për hir të politikës. Mbase e justifikojnë për hir të një të mire të madhe. Unë nuk e besoj shumë këtë.

Ina Kollcaku: Ama, politika ta jep apo ta merr dinjitetin?

Linda Rama: Nuk është dhe nuk mund të jetë o ta merr, o ta jep. Nuk ka lidhje. Dinjiteti është shumë personal, e ke vetë në dorë. Dhe patjetër, politika është investim edhe në dinjitet. Sepse të ballafaqon. Është shumë lehtë kur nuk je brenda në politikë, të kritikosh atë që është në politikë. Jeta pranë Edit politikan dhe kryeministër, më ka mësuar shumë gradualisht, dhe tani e kam bërë gjithnjë dhe më shumë timen që t'i them vetes, ti nuk i di të gjitha. Kjo është shumë e rëndësishme. Një njeri duhet t'i japë vetes mundësinë të mos ta çojë diskutimin deri në ekstrem, gjykimin deri në ekstrem, se ke nevojë të dëgjosh dhe tjetrin, dhe pastaj diskutimi mund të bëhet më cilësor, më realist dhe më i dobishëm. Ti nuk i di të gjitha. Dhe këtë unë e kam mësuar gradualisht. Derisa tani e kam bërë timen. Dhe unë pres, jo që ti di të gjitha, të di më shumë dhe duke ditur më shumë në një farë mënyre, kuroj edhe atë diskutimin tim, edhe mendimin tim, po edhe kontributin, po edhe gjykimin. Se gjykimi i padrejtë është një ngarkesë negative për të gjithë. Edhe për veten tënde. A mund të rri shoqëria civile si rri shoqëria civile me pushtetin? Po varet. Është si ajo që dimë në të përgjithshmen. Shtrëngo dhe lësho. Nëse të dy krahet e kanë premisën për të komunikuar dhe kuptuar njëri-tjetrin, të dy kanë premisën për t'u përmirësuar. Shumë e thjeshtë. Dhe mos të harrojmë që shoqëria civile është në nevojë për aleatë. Pushteti përgjithësisht është i fuqishëm. Është shoqëria civile në nevojë. Shoqëria civile është një ndjeshmëri e shtuar për kauza të përgjithshme, është e zhveshur nga egot. Pushteti është shumë më i veshur me ego. Shoqëria civile nuk i ka këto ego. Ajo është një kampanë, ajo i bie një zileje dhe thotë, dëgjo, dëgjoje edhe këtë zilen, se kjo është një zile e rëndësishme. Dhe unë mendoj që është fuqia e pushtetit ajo që hap veshin, duhet të hapi veshin dhe ta dëgjojë atë zile. Se është për një qëllim më të mirë dhe këto qëllime mundet edhe të integrohen me njëra-tjetrën. Atëherë, si mund të qëndrojmë bashkë? Ja pra, duke e mësuar njëri-tjetrin, duke u mësuar që ta marrësh në konsideratë tjetrin, ta dëgjosh. Pastaj, sigurisht të bësh më të mirën me atë që ke në dorë. Për median, nuk mund të them të njëjtën gjë. Media nuk është e zhveshur nga ego apo jo?

Ina Kollcaku: Nuk e di, ma thoni ju...

Linda Rama: Jo unë mendoj që nuk është. Ne e shohim në të përditshmen tonë median si pushtet. Shoqëria civile është një lloj tjetër pushteti, është pushteti i shpirtave, i mendjeve të hapura, i njerëzve që duan të kenë një dobi përtej vetes, njerëz që kujdesen për planetin, njerëz që kujdesen për pabarazinë. Janë kauza shumë fisnike, kauzat për të drejtat, për liritë. Janë kauza shumë fisnike kauzat e shoqërisë civile. Media e ka raportin me të vërtetën apo jo?

Ina Kollcaku: Me lirinë e fjalës ...

Linda Rama: Liria vjen me përgjegjësitë. E diskutojmë edhe këtë nëse jeni të interesuar. Vjen në momentin që i ke përballuar të gjitha peshat e përgjegjësiave. Dhe kjo vlen edhe për median. Dhe kush janë përgjegjësitë? Përgjegjësitë janë që ti të gjithë gamën e kodeve ta zbatosh. Dhe kush është gama e kodeve? Kodet janë kodi në raport me ligjin, kodi në raport me mjedisin, kodi në raport me të drejtën, kodi në raport me lirinë, kodi në raport me familjen. Nëse ti i ke plotësuar të gjithë kodet atëherë, liria të bën sens. Shpalosi të gjitha këto dhe pastaj shijo lirinë tënde.

Ina Kollcaku: Te liria do ndaloj! Nuk do marrë absolutisht asnjë minutë televizive të japë mendimin tim për median, por ama gjatë kohës që unë ju ëndërroja, juve ju mori Anila Basha në një super intervistë në fakt. Dhe duke cituar një titull fantastik, që ishte “Liria është pushteti im”. Çfarë mendon që donte të thoshte Anila me këtë?

Linda Rama: Atë titull, mbas përgjigjeve të pyetjeve të mia, e ka nxjerrë vetë Anila. Dhe unë këtë e kam shijuar personalisht. Ti mund të mendosh një gjë për veten tënde, por nëse nuk perceptohet, atëherë nuk ke arritur akoma që ta transmetosh në një mënyrë të tillë që ajo të jetë e perceptueshme. Kur Anila e nxori atë titull, unë u impresionova shumë pozitivisht. Nga ana tjetër, po. Më kanë pyetur edhe mikesha të miat për shkak të fëmijëve të tyre që kanë parë kopertinën. Çfarë do të thotë kjo? Nuk e kupton fëmija këtë. Dhe mua më ka ardhur shumë mirë që mikeshat e mia më kanë thënë “më pyeti djali, po kjo mami çfarë do të thotë? Çfarë do të thotë Linda me këtë? Pashë teta Lindën atje tek Billboardi. Kishte shkruar kështu. Ç’ishte ajo? Dhe ky diskutimi im tani është për fëmijët. Liria vjen gjithmonë me përgjegjësi. Këto të dyja nuk i ndan dot. Nëse ti nuk merr përgjegjësi, ti nuk mund të ushtrosh lirinë, sepse liria e një njeriu që nuk merr përgjegjësi mund të jetë dhe e dëmshme, jo vetëm për të, mund të jetë e dëmshme edhe për të tjerët.

Ina Kollcaku: Për lirinë e dikujt tjetër.

Linda Rama: Jo, mund të jetë e dëmshme për gjithçka. Nëse ti je një njeri që thua unë do bëj këtë, sepse kështu mendoj unë, kjo mund të jetë shumë e rrezikshme, madje ndonjëherë shumë e rrezikshme. Atëherë ti ke nevojë të marrësh disa përgjegjësi dhe kush janë këto përgjegjësi? Përgjegjësitë krijohen me kalimin e kohës. Janë peshat që merr. Dhe këtu janë ato që permenda edhe në rastin e paraleles me median. Janë kodet. Që të gjitha së bashku janë kodiku jot. Kush janë? Kodi ndaj punës. Ti do ta respektosh këtë. Çfarë kodi ke me punën? Çfarë kodi ke me familjen? Çfarë kodi ke me mjedisin? Çfarë kodi ke me shoqërinë? Çfarë kodi ke me ligjin? Çfarë kodi ke me etikën? Të gjitha këto i shpalos, dhe në momentin që ti i shpalos, në fakt, të gjitha këto, atëherë ke mundësi që të fillosh të ndjesh shijen e lirisë së mendimit, të veprimit dhe të fjalës. Sepse vetëm atëherë liria e mendimit, veprimit dhe fjalës të merret seriozisht. Dhe mendoj që unë sensin e lirisë e kam patur premisë të brendshme. Unë lirinë nuk e negocioj me asgjë. Mund mos ta shoh te vetja ime, por unë nuk resht së thëni atë që dua, që mendoj, që ëndërroj. I shoh shumë gjëra tek vajza ime tani dhe jam e lumtur, e kam arritur. Unë lirinë nuk dua ta shoh te vetja, dua ta shoh te të tjerët, aq më shumë te fëmija, që është një siguri e jashtëzakonshme dhe konfirmimi i asaj që ti ke bërë. Babai im them unë ka qenë i pari që kuptoi sensin, prirjen e lirisë, kërkesën e panegociueshme qysh kur isha e vogël. “Ti i jep krahë Lindës”. Kjo ishte shprehja në shtëpinë time, në familjen time. Ti i jep krahë, që do të thotë, ti i jep besim dhe liri Lindës. Kjo e ka shoqëruar gjithë fëmijërinë time. Vonë e kam menduar këtë, ku e gjeti babi im këtë garanci që më vuri mua kaq shumë krahë. Ku e gjeti? Babai im mendoj unë ka patur një intuitë të jashtëzakonshme. Ai ka kuptuar që unë kam një vullnet të përditshëm dhe insistim të përditshëm për të qenë një fëmijë i mirë. Ai ka kuptuar këtë dhe kjo i ka dhënë sigurinë që unë nuk abuzoj me atë që më jepte ai. Përndryshe, është e vështirë ta marrësh lirinë që kur je e vogël. Unë e kam marrë që kur kam qenë e vogël dhe unë jam shumë mirënjohëse babait tim për këtë, sepse kjo më ka dhënë mundësinë të jem kjo që jam, të eksploroj e pa frikësuar botën dhe të kërkoj atë që është më e mirë për veten time dhe për të. Kështu që, kjo është, besoj unë, edhe kuptimi i atij titulli. Liria është pushteti im, është një zemër e trimëruar. Po si është e trimëruar? Është e trimëruar me përgjegjësitë që ka marrë përsipër mbi këmbë. Dhe ato këmbët dhe peshat që merr përsipër, si çlirohen ato? Duke të dhënë komoditetin për të shijuar lirinë. Dhe ia vlen t’i marrësh ato pesha për të qenë një njeri i lirë në mendim, një njeri i lirë në veprim dhe një njeri i lirë në fjalë, duke thënë atë që mendon.

Ina Kollcaku: Më bëri shumë përshtypje që the më morën mikeshat në telefon dhe gjithmonë kam qenë kurioze, a keni shumë mikeshat dhe cilat janë temat e diskutimit me to në një gjendje ku Linda është Linda, shoqja e tyre.

Linda Rama: Unë s’e ndaj asnjëherë këtë. Miq, mikeshat, zonjë, zotëri. Unë kam miq që janë edhe burra, dhe djem, dhe gra, dhe vajza. Dhe njëkohësisht në të gjithë jetën time janë ato aleatët që ju thashë. Unë dhe një bisedë me një njeri, të cilin nuk e kam mik, nuk e kam madje as të njohur e marr. E kam marr gjithë jetën time mundësinë që nëse kam dëshirë të zhvilloj një bisedë me të, e kam zhvilluar dhe çdo njeri ka diçka për të shtuar në bisedë. Edhe njeriu më i thjeshtë që mund të ekzistojë. Për shembull, para pak ditësh takova dikë në një kurs ku çoja Zahon. Nuk e

njihja. Ma ka dhënë babai porosi, tha “nëse je faqebardhë, ballafaqohu pa frikë.” Kjo është një gjë shumë e madhe. Nëse je faqebardhë, pasi nëse nuk je, fuqinë e ballafaqimit duhet ta ri vizitosh. Dhe nga njerëz të thjeshtë, merr shumë. Në ndërkohë, në shtëpi kur kemi qenë të vegjël përsëri të dy, edhe mamaja edhe babai, veçanërisht babai që ishte artist dhe më i ndjeshëm, na e thonin gjithmonë dhe besoj aty e kam marrë unë rëndësinë e bisedës. Na thonin: “Mos fol për punën e një njeriu tjetër, merru me punën tënde”, “mos e gjyko tjetrin nga pamja e jashtme” ose “mos iu qas, sherri vetëm sherr sjell”. Kanë qenë porosi që babai im nuk t’i impononte. Babi është një rrëfimtari i jashtëzakonshëm. Mendoj dëgjuesi dhe rrëfyesi më i bukur, më i mirë që unë kam patur që në vogëli. Dhe babi, për shembull, nuk e mbaronte këtui. Babi vijonte me sepse. Dhe ose i referohej një libri, ose një ngjarje ose një rrëfimi fetar që tek babi ishte shumë prezent për shkak të bisedave që bëheshin në komunizëm në ato tryezat familjare ose të një eksperiencë që ai kishte patur. Por gjithmonë ta çonte deri në fund bisedën nëpërmjet një ngjarje konkrete, e cila të tregonte dhe konsekuencën. Gjithmonë na thoshte: – Fukarallëku është një gjendje që edhe ndodh, por janë dy komponentë, dy gjëra që njeriu i ka në dorë, të mos bien në fukarallëk. Kjo është koha, edhe fjala. Të dyja mund t’i përdorësh për të pasuruar veten, edhe kur nuk ke ca gjëra të tjera. Dhe unë e kam kuptuar shumë herët që fjala dhe koha janë elementë që e pasurojnë njeriun. Kështu që bisedës i jap një rëndësi të posaçme. Në jetën time kam patur edhe fatin që në punërat që kam bërë, në mjediset që kam frekuentuar të jem ndeshur me shumë njerëz, me të cilët kam qëndruar në harmoni, dhe shkëmbimi gjithmonë ka sjellë diçka reciproke.

Dy gjëra dua të them: E para për miqtë dhe të njohurit e mi. Periudha me Edin kryeministër, për shembull, është një periudhë sprove që vazhdon, është një periudhë sprove e madhe, ku nuk je vetëm ti në sprovë, është i gjithë mjedisi në sprovë. Një gjë që mua më ka impresionuar shumë dhe më emocionon shumë është fakti që miqtë e mi të rinj apo jo të rinj, të hershëm dhe shumë të hershëm i kanë qëndruar me një elegancë kaq të madhe pozicionit tim, sa që kurrë nuk ka qenë, me raste shumë të rralla, e nevojshme t’ia kujtosh. Atë që unë mund të kem transmetuar si pjesë të profilit tim, apo vetë unë në të përditshmen time, po edhe nëpërmjet komunikimit publik në intervista, ata e kanë besuar plotësisht. Dhe përkundrazi, unë jam e bindur që ata janë njerëz, të cilët kanë nevojë në të përditshmen e tyre, që unë mund t’jua zgjidhja shumë lehtë. Po si nuk trokasin ata? Si janë kaq elegantë? Si janë kaq mirëkuptues? Po janë të vërtetë pra. Ata kështu kanë kaluar një sprovë shumë të madhe. Ato dinë mënyrën se si të jenë prezent në jetën time. Në një moment unë marr një zemër nga një shok i shkollës fillore në celularin tim. Aq, vetëm aq. Një shenjë që në atë moment, mendimi atë person e ka çuar tek unë. Ata janë atje dhe unë e di që ata janë mbrojtësit e mi dhe ata e kanë mbajtur me elegancë të jashtëzakonshme këtë lloj gjëje. Dhe ky, mendoj unë, është një kulmim. Siç e kanë mbajtur me një elegancë të jashtëzakonshme miqtë që unë konsumoj të përditshmen. Po unë kam një mikeshë që konsumoj ritualin e kafesë së mëngjesit, kam prej dekadash. Kam patur gjithmonë dy-tre njerëz të rëndësishëm në mëngjesin tim me radhë ose së bashku. Kafja është edhe ftuese, po është dhe shoqëruese e bisedës. Aty t’i ndan gjithmonë, nuk e di, kuriozitet, ngjarje, dilema, emocione, futesh thellë, ngjitesh lart. Ai gjysmë orësh, tre çerek orësh, i qëndruar përtej pozicionit, është i motivuar nga dëshira për të shkëmbyer, për t’u përmirësuar, për t’u paqëtuar, për t’u qetësuar, për të gjitha shijet e jetës. Dhe nëse ti e arrin këtë lloj gjendje, mendoj, atëherë, kjo është një nga ato stolitë, që janë stoli të jashtëzakonshme të jetës dhe shije që ti nuk mund t’i ndërrosh me shumë gjëra të tjera që mund të të ofrohen. Përfshirë dhe pushtetin që nuk dua t’i vë fare epitete. Që mua më duket më i varfër

se kjo që jetoj. Ai gjysmë orësh, ku i kam brenda të gjitha bisedat, edhe ato biseda të mëdha që bëhen krijon edhe një kulturë tolerance të caktuar që pozicione të tjera nuk ta japin dhe të ndihmon pastaj për energjinë e gjithë ditës. Nuk e di, e kam zgjedhur fatin, më ka gjetur fati, më kanë gjetur ata mua apo i kam zgjedhur unë si të tillë. Unë këtë nuk di ta them. Po unë di të them që në tavolina apo një nga një, me përjashtime, sigurisht me përjashtime, që galeria e miqësive t'i ofron e nuk të shpëton dot në një jetë kaq shumë dekadash sa jam unë, e konsideroj veten me shumë fat për të njohurit, për miqtë e mi, edhe për të gjithë ata njerëz të zakonshëm, të cilët në një moment kanë ditur apo unë kam gjetur mënyrën se si të marrë nga ato më të mirën e tyre.

Ina Kollcaku: Si ndiheni nga njerëzit që e di që duan patjetër të marrin një copë nga ju? Si mund të bëni një balancë kaq të mirë dhe kaq të qetë dhe kaq të paqte, pa një protestë të zëshme, si për shembull, unë që dua të nxjerr shpatën zakonisht. Si arrini përpos mençurisë të jetoni në këto balanca dhe cila është përgjigja juaj ndaj njerëzve abuzues përfitues që nuk e di nëse është vetëm përshtypja ime, po janë aq të dukshëm.

Linda Rama: Përgjigja kryesore është raporti me të vërtetën. E vërteta është brenda teje, kjo është përgjigja. Domethënë, ajo e vërteta brenda teje, është ajo që ty të vendos në një ekuilibër të jashtëzakonshëm. Më pas, sigurisht, kjo është një premisë e domosdoshme, por ti ke nevojë edhe ta transmetosh të vërtetën tënde dhe gjen forma të ndryshme. Unë e kam shumë të rëndësishme brenda vetes time, mirëqenien e tjetrit, unë e kam të rëndësishme kohën e tjetrit, unë e kam të rëndësishme radhën e problemeve. Problemet e tjetrit mund të jenë më të mëdha se halli im për të thënë të vërtetën time. Unë e respektoj jashtë mase vëmendjen e tjetrit. Unë arrij të futem tek lëkura e tjetrit, bëj përpjekje për këtë. Për ta kuptuar nga se u motivua, pse e bëri? Si është kjo? Duhet ta them tani apo jo, është vëmendja këtu apo s'është? Është e dobishme apo s'është? Janë të gjitha këto pyetje që të shoqërojnë dhe sigurisht, unë gjej mënyrën, gjithkush që mund të cenohet në një moment padrejtësisht e gjen mënyrën. Unë e kam gjetur mënyrën dhe jam ballafaquar në momentin që kam menduar, që e vërteta ime ka rëndësi të komunikohet. Kaq. Unë nuk përpiqem të bind njerëzit me domosdo, sepse jeta e krijon vetë bindjen e vet, kërkon rrugëtimin e vet, kërkon kohën e vet dhe tjetri. Ama, unë në një moment e kam ndjerë, unë dua ta them të vërtetën time dhe kam dalë e kam thënë të vërtetën time, ashtu siç e mendoj. Ndërkohë që, atë moment kur unë kam dalë, kam thënë të vërtetën time, kam thënë vëmendja e tjetrit duhet tek unë tani, sepse unë dua ta them këtë dhe unë mendoj e kam merituar, se kam pritur gjatë. Dhe e kam thënë. Për shembull, unë jam një figurë publike sot për shkak të Edit që mund ta marrë vëmendjen e televizionit, e një interviste për të thënë një të vërtetë timen, ose për të marrë vëmendjen e medias së shkruar, që një shkrim timin ta botojë ose intervista të cilat më bëhen herë pas here. Domethënë, unë e marr vëmendjen dhe e them, por fjala vjen, Rea vajza ime, kur i kanë rënë në qafë padrejtësisht, dhe nuk i kanë rënë pak Reas për llogari të caktuara, Rea ka duruar, gjatë ose shkurt, aq sa e ka menduar ajo, dhe ka gjetur mënyrën institucionale për t'u ballafaquar, me padi në gjykatë. Shumë e thjeshtë. Rea ka përballuar tetë vite me radhë fyerjen politike. Tetë vite. Tetë vite janë shumë për një vajzë që ka qenë, të themi, në atë momentin kur

ka filluar kjo fyerje 25 vjeç dhe duron deri në 33 vjeç. Pse duron? E para është e vërteta që e mban. Ajo nuk e ka fare problem të vërtetën për aq sa ajo e di. Po, pse duron? Duron sepse mendon që janë ca gjëra të tjera më të rëndësishme, që kanë ca njerëz të tjerë gjëra më të rëndësishme për të thënë. Deri në momentin kur mendon që jo, se kjo mund të jetë një dëm i madh publik. Në kuptimin e njerëzve, të cilët ushtrojnë vendimmarrje publike dhe e kanë kaq lehtë të cenojnë jetët e njerëzve për llogaritë e tyre të vogla, do thoja unë, se nuk të çojnë asnjëherë në llogari të mëdha këto. Dhe ajo çon në gjyq burra dhe gra, që padrejtësisht vihen në dispozicion kundër saj, që nuk gjendet fare në arenën e tyre, të cilët janë të strehuar në shtëpinë më të madhe të ligjeve të popullit shqiptar, që është parlamenti. Apo jo? I çon atje. Pse i çon atje? I çon atje, se atë mënyrë gjen ajo për të protestuar dhe beson që gjykimi do të shkojë në nivelin e të vërtetës së saj. E ka fituar Rea gjyqin me median. 7 burra të medias Rea i hodhi në gjyq. E fitoi ajo betejën me ta, pse? Sepse shpifën për të. E fitoi me 7 burra, dhe unë jam ndjerë shumë mirë kur vajza ime vuri 7 burra në akt padi dhe i çoi në gjykatë. Ky është moment i madh sigurie, kontributi, durimi, gjithashtu edhe kurajoje.

Ina Kollcaku: Dhe mençurie...

Linda Rama: Po patjetër janë të kombinuara.

Ina Kollcaku: Pashë që Kreshnik Spahiu deklaronte që po lë ndeshjen e futbollit për të parë Linda Ramën, ndërkohë, kujtoi dhe momentin kur Batoni Haxhia plasi një bombë në ekran dhe thotë Presidenti i Shqipërisë, Linda Rama.

Linda Rama: Këto janë burrat që flasin mirë për gratë. “Linda nuk është zonjë e parë, por është e para zonjë” e ka thënë Kreshnik Spahiu, dhe unë jam surprizuar shumë. Një ditë pas intervistës, apo atë ditë, nuk mbaj mend kur ma dërgoi mikësja ime, e surprizuar dhe e lumtur gjithashtu, që ishte ai reagim. Dhe ai e shpjegon vetë. Po pse ka rëndësi kjo e thënë nga Kreshnik Spahiu, që nuk e njihja, nuk më njihje dhe papritur ishte shprehur. Dhe Batoni sigurisht futet në këtë logjikë, mendoj unë në këtë kurajo. E para, Kreshniku që nuk më njihje mua, dhe kjo më ka surprizuar, kishte patur kuriozitetin për të më njohur dhe për të më dëgjuar. Nuk është e shpeshtë që kurioziteti të ndalojë te bashkëshortja. Te bashkëshortja ndalon vetëm gabimi, faji. Kur duan të gjejnë fajin, shkojnë te bashkëshortja. Por kurioziteti për të parë se kush është bashkëshortja, që nuk është në jetën aktive politike dhe publike, nuk ndodh. Ai e pati kuriozitetin dhe mua kjo më surprizoi. Aq më shumë që ka qenë edhe një aktor politik më parë, se ka patur lëvizjen “Kuç e Zi”, pra është ballafaquar politikisht me Edin. E dyta, ai jo vetëm që pati kuriozitetin, po ai nuk dyshoi në rrëfimin tim. Kjo është fuqi shumë e madhe. Të kesh fuqinë për të besuar, është po aq e madhe sa të kesh dobësinë për të dyshuar pa prova. Besimi në distancë është shumë i fuqishëm dhe unë kam parë gazetarë, të cilët të thonë që nuk ka mundësi që të jetë kështu. I them, po më jep një provë. Ndërkohë që unë kam provuar gjithë jetën time të kundërtën, “unë provë nuk

kam”-thotë, “por unë nuk të besoj”. Por kjo është dobësi shumë e madhe e një burri, veçanërisht që të mos besoj fjalën e gruas, kur ajo e thotë kaq prerë. E treta pastaj në rastin e Kreshnikut ishte fuqia e tij, kurajo për t’u shprehur, për të mos ta mbajtur për vete, po për t’u shprehur në publik. Këtu është edhe Batoni. Pse? Sepse burrat në këtë rast japin nga domain- i i tyre. Apo jo? Ai ka dhënë diçka dhe ky është moment i rëndësishëm emancipimi. Kjo është arsyeja që Ilva iu kthye juve, ju ka mbetur në mendje dhe më ndodh edhe herë pas here që kjo ka qëndruar në mendjen e njerëzve. Pse ka qëndruar në mendjen e njerëzve? Ka qenë kuraja e njeriut që e tha dhe tha një gjë që nuk është e zakonshme.

Ina Kollcaku: Ose ka thënë një gjë që e mendojmë te ne të tjerët.

Linda Rama: Po mua më njohin shumë njerëz në jetë, më njohin. Unë jam një njeri që kam miqtë e mi, kam kolegët e mi, kam aleatët e mi. Unë jam në një farë mënyre shumë e privilegjuar, sepse në momente kur ka qenë një diskutim i lidhur me mua, mua më janë bërë krahë, në fakt. Unë e kam marrë këtë kënaqësi, burra dhe gra kanë qenë aleatët e mi, edhe në mënyrë të shprehur publikisht. Ama në atë moment ai zgjodhi, ai që nuk më njihte zgjodhi, dhe ky është moment emancipues. Edhe diskutimi për presidentin nuk ka rëndësi, është Linda, është një vajzë tjetër. Diskutimi për presidentin, për kryetarin, kur futet në domain-n e një gruaje dhe artikullohet nga një burrë, këta janë burra të civilizuar, të cilët janë gati të japin nga domain-i i burrave, edhe tek një grua, sepse kështu mendojnë që mund të jetë më e dobishme.

Ina Kollcaku: Kishte dhe zëra që e aprovinin atë kohën.

Linda Rama: Mos të harrojmë që ka burra politikanë që dalin sot në televizor, kërkojnë 20 herë falje pse po përmendin gruan e tyre. Kërkojnë ndjesën e parë, se burrave nuk i takon të flasin për gratë. Kërkon ndjesën e dytë, mos ma keqkuptoni. Kërkon ndjesën e tretë... Po çfarë është kjo? Pse ke nevojë të bësh kaq ndjesa. Për çfarë? Për një meritë të gruas tënde. Po grua ka investuar tërë jetën për të, pse e dashka me kaq falje dhe me kaq ndjesa nga burri i saj, të ketë konfirmimin e një gjëje që ai e jeton. Dhe këto momente emancipuese janë të rëndësishme për mjediset tona, jo për ato që përmenden, janë për të tjerët. Krijon një mindset tjetër, ashtu sikundër pesha e paragjykitimit në vite për figurën femërore, për vajzat dhe për gratë, është një peshë që ne vajzat dhe gratë e mbajmë përditë. “Kulaçin e shtrembër e bën nusja”, vazhdon dhe e ka nusja në kurriz, si element paragjykimi. Ende qëndron si barrë mbi ne dhe është një barrë fare e padrejtë. Se “kulaçin e shtrembër” në shumë raste e bën burri. Apo jo? Nuk e bën nusja “kulaçin e shtrembër”, madje, nusja bën ca kuleçër, të cilat burrat e kanë shumë të pamundur t’i bëjnë. Janë domain-e që burrat nuk duan fare të futen dhe është një përpjekje shumë e madhe që t’i bësh aleatë në këtë drejtim, që ne gratë të vajzat nuk lodhemi, nuk jemi lodhur në shekuj gradualisht. Do bëjnë dhe ata kuleçërit tanë, aq sa lejojnë ligjësitë natyrore dhe ne do të marrim gjithnjë e më shumë nga domeni që na takon, jo nga i tyre, nga ai që na takon.

Ina Kollcaku: Nga ai që na kanë hequr.

Linda Rama: Jo na kanë hequr, ai që na takon, na përket. Koha kështu vjen, duke evoluar. Rëndësi ka që të jetë në përmirësim.

Ina Kollcaku: Nëse do përfytyroja një moment ju dhe kryeministrin Edi Ramën në shtëpi, në një moment të relaksuar, duke lexuar një libër, çfarë libri do të ishit duke lexuar ju dhe çfarë libri do të ishte duke lexuar Edi?

Linda Rama: E para, koncepti i leximit ka ndryshuar. Le të fillojmë nga kjo. Sepse libri nuk lexohet më vetëm në letër, libri lexohet në ekran, të vjen edhe me dëgjim nga veshi herë pas here dhe sigurisht, e përditshmja jonë nuk na bashkon shpesh në këto momente, që juve imagjinoni. Se është e pamundur. Me librin, në çfarëdo lloj forme që vjen leximi, në mënyrë të përbashkët kontaktin e kemi në avion, kur jemi në ndonjë udhëtim. Gjithmonë, Edi ka librin e vet, unë kam librin tim. Dhe në pushime. Në pushime e kemi këtë lloj komoditeti. Pra është me episode shumë të vogla. Ndërkohë filmi është më prezent kur kemi mundësi, kuptohet, po mundësia është në darkëqë të mund ta kesh syrin në ekran. Mund të na imagjinoni duke parë një film së bashku. Për shembull, kush është filmi i fundit që kemi parë? Së pari, leximi është pjesë edhe punëve që ne bëjmë, por Edi është një lexues që të impresionon. Të impresionon në sistematicitetin që ka me atë peshë të punës së përditshme, për të qëndruar në kontakt me librin, me leximin në përgjithësi, me lajmin, me botën, me momentet avangard të shkencës, me momentet avangard të politikës, me debatet. Është impresionues sistematiciteti i Edit në këtë drejtim. Ndërkohë që filmi, një nga filmat e fundit, mbase i fundit është ky që kemi parë, është një serial, “Little Disasters” me Diane Kruger, një serial 6-7 shtatë seri. Nuk e mbaj mend sa ishin në total, po e mbarova, e përthitha, e përthithëm. Kemi ndenjur deri vonë e kemi parë. Pse më pëlqeu ky film për shembull? Më pëlqeu sepse tregonte se ku të çon një dyshim, qoftë dhe i arsyetuar. Ishte një mënyrë e jashtëzakonshme për ta parë këtë lloj skenari, një person i dyshuar në mënyrë të arsyetuar dhe i futur në morsën e një protokolli mjekësor që kërkonte shpjegim për një ngjarje që i kishte ndodhur fëmijës. Si u dyshua deri në ekstrem ky person nga institucionet? Nuk kishte bërë gjë, thoshte nuk e di. Dyshimi i arsyetuar gjithkënd e çoi në arrogancë, e çoi në paragjykim, e çoi në gjykim, e çoi në cinizëm. Secili përdorte mënyrën e vet për të shprehur atë, që ti nuk po më thua mua, atë që në fakt është kështu. Dhe ti aty e kupton sa e rrezikshme është kjo dhe në fund se si mund të mbetet dinjiteti prindëror, i nënës që thoshte “nuk di gjëse si ka ndodhur”, dinjiteti i institucioneve si policia, gjykata, shërbimet sociale, shoqëria, të gjitha institucionet, mjekësia, mjeku, tek një fëmijë i vogël, fëmija i shtëpisë, i cili dinte të vërtetën. Ai shpëtoi dinjitetin e të gjithëve nga dyshimi i arsyetuar, sepse ai foli. Dhe si? Si nevojë e mbrojtjes së motrës së tij nga në fakt, ai që kishte shkaktuar dëmin. Në një moment, ai preku motrën, atij iu rikthye ngjarja dhe ai i shpërtheu gjithë frikërat e veta. Fëmija i vogël, në klasë të dytë a të tretë tha jo, – mos e prek.

Donte të mbronte motrën dhe në fakt kishte në dorë nënën që ia futën në burg, babain që ishte në dramë se kishte tre fëmijë për të mbajtur, kushtet e nënës që nuk e besonte njeri, policinë, gjykatën, gjithkënd. Aty ti e kupton se sa durim duhet të kesh, se sa fuqi duhet të kesh që mos të jesh cinik, mos të jesh paragjykses, mos të jesh gjykses fundor. Se ja, kaq e thjeshtë është. Mund të bësh një dëm shumë të madh dhe një dëm të pariparueshëm. Ka shumë sot mënyra për të parë eksperiencat, për të parë edhe fantazinë krijuese, pasi janë fiction një pjesë shumë e madhe e filmave. Po pse të çon fantazia aty? Se ato perceptohen nga regjisorët, nga skenaristët si rreziqe të botës që jetojmë. Pra, Edi në kolltukun e vet, unë kolltukun tim. Jo duke lexuar. Ajo ka qenë shumë herët. Po mund të jetë me film, mund të jetë në forma të tjera. Duke shijuar atë pjatën e ushqimit që e gatuaj unë vetë çdo darkë, duke bërë një bisedë, qoftë edhe të vogël, duke qëndruar me presionin. Ne duke bërë presion mbi Zahun, Zaho mbi ne. Ai për t'i shpëtuar përgjegjësi, ne për t'i venë ca më shumë përgjegjësi mbi shpatulla. Kështu që ja, këto janë dinamikat, si në çdo shtëpi tjetër, mendoj unë. Edhe në shpinë tuaj kështu është me siguri.

Ina Kollcaku: Ndërkohë këtë vit u zgjuam tmerrshëm, le të themi, me çdo gjë që po ndodh, me situata globale që të them të drejtën, për një vajzë si unë, unë jam 31 vjeç. Kam vite që luftoj, kam vite që dua të luftoj dhe shpresoj që të bëj gjëra gjithmonë edhe më të mira dhe të bën të diskutosh pak, a që është gjithmonë politika ajo që e çon botën para apo jo? Në opinionin tuaj çfarë do të ishte tjetër e nevojshme përveç politikës që ne të garantojmë këtë paqen?

Linda Rama: Nuk është vetëm politika që e çon botën para. Absolutisht jo. Sigurisht politika është një instrument i jashtëzakonshëm dhe një domain i jashtëzakonshëm për vendimmarrje të mëdha, të cilat kanë rezonancë shumë të fuqishme publike. Por janë shumë aktorë që e çojnë botën përpara. Avancimi teknologjik nuk është politik. Avancimi teknologjik është avancimi i mendjeve brilante, i biznesit, i korporatave, fantazia e të cilëve me talentin që kanë i çon në hënë sot, për të zhvilluar realitetin industrial në univers, jo në botën ku jetojnë njerëzit. Domethënë, fantazia dhe talenti shkojnë shumë larg dhe këto e çojnë botën, sigurisht, përpara. Shoqëria civile, kontributi dhe reflektimi i saj. Në momente traumash të mëdha për botën, siç janë luftërat, janë ato që kanë nxitur krijimin e institucioneve të mëdha, siç është institucioni i UN, për shembull dhe ndërmarrja e axhendave të dakordësuara përtej kufijve. Përveç shoqërisë civile, është media, janë shumë faktorë të tjerë që e çojnë botën në fakt përpara. Janë institucionet fetare, janë të gjitha që kontribuojnë së bashku. Është e vërtetë që bota sot për shkak të të gjitha avancimeve që kanë ndodhur në çdo lloj fushe apo drejtimi, gjendet në presione të mëdha. Këtë ndjejmë ne sot, ne ndjejmë një presion. Globalizmi është një presion, apo jo? Shpejtësia e komunikimit me të cilin ne ballafaqohemi me lajmin, është shumë e shpejtë. Shpejtësia është një presion tjetër. Mirëqenia, konsumizmi është një presion tjetër, apo jo? Dëshira për më shumë balancë midis jetës dhe punës. Ky është një presion tjetër që brezi i ri me të drejtë e synon. Janë shumë presione sot për shkak të gjithë këtyre avancimeve të mëdha. Bota gjendet në presion. Janë edhe konfliktet, janë rizgjuar ca të vjetra ose ka konflikte të reja. Këto e fusin botën në një lloj tensioni, që sigurisht duhet të marri vëmendjen e duhur. Por që është evoluim dhe jam e bindur që njerëzimi do ta gjejë rrugën e vet për t'i vendosur në trasetë minimalisht të eliminimit

të rreziqeve të mëdha. Çështja e eliminimit të rreziqeve të mëdha është kryesore. Çfarë do bëja unë? Mua, për shembull, dy gjëra më lëndojnë. E para, është mungesa e paqes së përgjithshme. Unë luftën nuk e dua, lufta nuk sjell asgjë, asgjë të mirë nuk sjell lufta dhe është e padrejtë. Lufta nuk ka fitues. Nëse ju dëgjoni, “unë e fitova”. Jo, nuk ka. Asnjë luftë nuk ka fitues. Po sikur edhe një jetë të humbi, është humbje. Ajo është e rëndësishme, ajo jeta është shumë e rëndësishme. Ka ardhur si pjesë e një vullneti për të bërë një gjë tjetër, jo për të ikur. Nëse nuk ka arsye për të ikur. Nga njeriu, jo, jo. Dhe diskriminimi! Është varfëri e madhe diskriminimi. Nuk e dua një botë me diskriminim. Dua një botë me paqe dhe me dashamirësi mbi bazën e asaj që siç thoni ju, emëruesit të përbashkët që kemi të gjithë, mbi atë emëruesin e përbashkët, të cilin ne nuk duhet ta negociojmë. Pastaj, le të vazhdojmë të shpalojmë vullnetet tona, talentet tona, mendimet tona, gjithçka tjetër, kontributet tona, po që ngrihet mbi atë emërues, atë emërues që i vendos njerëzit në atë nivel që i ka sjellë vullneti hyjnor, pavarësisht rrethanave.

Ina Kollcaku: Të them të drejtën, nuk e prisja që në një pyetje ku në imagjinatën time kishte luftëra dhe problematika globale. Mua përgjigja juaj t’me jepte kaq shumë shpresë dhe shpresa është një emocion jo shumë i njohur për mua. Pyetja më interesante që ju keni marrë jashtë intervistave?

Linda Rama: Më bën Zaho për ditë, pyetje interesante.

Ina Kollcaku: Po një për publikun.

Linda Rama: Po ja për publikun, pardje më pyeti ç’do të thotë fjala “sedër”? Dhe unë i thashë do mendohem edhe që të ta bëj një çik më të plotë shpjegimin. Ai nuk e kishte dëgjuar si fjalë ndonjëherë dhe e hasi në një bisedë dhe ai pyet gjithmonë për fjalët e reja, e ka një kuriozitet. I thashë, unë nuk ta shpjegoj menjëherë. E marr me Zahon, kohën që gjëra të caktuara që dua t’i jap. Përdor fjalën për t’i dhënë leksionin. Po, fëmijët kanë shumë pyetje interesante, jashtëzakonisht interesante. Kanë nevojë për mendim, sepse edhe mënyra se si ia transmeton duhet të jetë pak më e veçantë sesa mënyra se si kuptohemi ne të rriturit.

Ina Kollcaku: Unë dua t’ju falënderoj shumë që erdhët në Aromë Gruaje. Mendoj që është momenti më dinjitoz i emisionit tim dhe të bashkautorës time Vasilikës, por mendoj që është ndonjë moment shumë dinjitoz për Radio -Televizionin Publik Shqiptar tashmë ne kemi edhe një drejtoreshë grua, kështu që “Aromë Gruaje” merr kuptim gjithandej në Radio Televizioni Publik Shqiptar dhe na duhej edhe e para zonjë për t’u kurorëzuar në fund të fundit atë që është misioni jonë, faleminderit nga zemra.

Linda Rama: Faleminderit shumë, Ina.